

**ALEANCA PËR ARDHMËRINË E
KOSOVËS**

AAK

DRAFT - STATUTI

Prishtinë, Qershor 2019

PJESA I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1

PARTIA POLITIKE, EMËRTIMI DHE PARIMET THEMELORE

1. Emri i partisë është: **Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës**, në tekstin e mëtejshëm **AAK**;
2. Selia e Partisë është në Prishtinë, adresa: Bulevardi i Dëshmorëve, Nr. 49;
3. AAK është e regjistruar në regjistrin e partive politike, në organin kompetent të Kosovës;
4. AAK vepron në territorin e Kosovës, ndërsa organizimi jashtë vendit bëhet në pajtim me dispozitat ligjore të shteteve përkatëse;
5. AAK është parti politike, dispozitat, qëllimet dhe parimet e së cilës janë përcaktuar me Statut dhe Program politik. Qëllimet dhe parimet formësohen edhe me anë të deklaratave, rezolutave dhe vendimeve të nxjerra nga organet e AAK, konform Statutit dhe Programit;
6. Organizimi dhe veprimi i Partisë përcaktohen me Statut dhe akte të tjera të veçanta;
7. AAK bashkëpunon me partitë tjera simotra në Kosovë dhe vende tjera;
8. AAK e përfaqëson Kryetari dhe zyrtarët tjerë të përcaktuar me këtë Statut;
9. AAK e garanton lirinë e plotë të zgjedhjes dhe votimit të fshehtë;
10. AAK garanton dhe mbronë lirinë e plotë të shprehjes së gjitha forumet e saj.

NENI 2

SIMBOLET E AAK

AAK i ka simbolet e saj dhe vulën e rumbullakët, në të cilën shkruan: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Në mes të vulës shënon simboli: AAK, ndërsa vula e degës është e njëjtë me atë të Qendrës, ku shtohet emri i degës (dega në...). AAK ka edhe vulën katrore, në të cilën shkruan emërtimi i partisë dhe selia, numri vijues në të cilin shënohet numri i protokollit dhe data.

NENI 3

DOKUMENTET THEMELTARE TË AAK

1. Programi dhe Statuti i AAK-së janë dokumentet bazë për organizimin dhe funksionimin e Partisë;
2. Statuti përcakton organizimin e brendshëm të AAK dhe është akti më i lartë juridik i saj;
3. Programi përcakton orientimet ideologjike dhe strategjike.

NENI 4

ORGANIZIMI

1. AAK është e organizuar në nëndegë dhe degë; Në raste të veçanta konform Nenit 10 të këtij Statuti, mund të formohen edhe aktive.
2. Në strukturat e saj organizative, AAK ka: Kuvende, Këshilla Drejtuese, Kryesi, Grupin Parlamentar, Grupet e Asambleistëve, Aleancën e të Rinjve të Kosovës, Departamentet Profesionale, Sekretaritë, Komisionin Statutar, si dhe organet tjera që mund të themelohen konform këtij Statuti.

NENI 5

ANËTARËSIMI

1. Anëtar i AAK mund të jetë çdo qytetar i Kosovës, që ka mbushur moshën 18 vjeç, dhe i cili pajtohet me Programin e AAK;
2. Anëtarësimi bëhet në mënyrë individuale, duke pranuar librezën e partisë, mbi bazën e deklaratimit të lirë;
3. Anëtar i AAK nuk mund të jetë edhe anëtar i ndonjë partie tjetër;
4. Çdo anëtar i AAK, pavarësisht nga funksioni në AAK, duhet të jetë anëtar i nëndegës së AAK, në vendbanimin ku jeton apo ku ai vet zgjedhë;
5. Nëse anëtar i AAK e ndërron vendbanimin, ai duhet të informojë nëndegën bazë për adresën e re dhe të regjistrohet në nëndegën e vendbanimit të ri.

NENI 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT TË AAK

Anëtar i AAK ka të drejtë dhe detyrim:

1. Të marrë pjesë dhe të ndihmojë në aktivitetet e AAK;
2. Të zgjedh dhe të zgjidhet në organet udhëheqëse të AAK;
3. Të kandidojë për institucionet e pushtetit komunal e qendror të Kosovës, në përputhje me këtë Statut;
4. Të informohet me veprimtarinë e organeve drejtuese të partisë;
5. Të marrë detyrime për realizimin e programit të Partisë, të Programit Zgjedhor dhe të aktiviteteve të tjera të punës së AAK;
6. Të japë propozime për punën e AAK;
7. T'i përmbahet Statutit, Programit, vendimeve, orientimeve dhe qëndrimeve të AAK;
8. Të ruajë imazhin, autoritetin dhe interesat e AAK.
9. Ta nënshkruaj Deklaratën Etike.

NENI 7

PUSHIMI I STATUSIT TË ANËTARIT

1. Statusi i anëtarit në AAK, pushon:
 - a. Me kërkesën e anëtarit;
 - b. Me përjashtimin e anëtarit;
 - c. Me vdekjen e anëtarit;
2. Vendimin për përjashtimin e anëtarit, sipas pikës 1 paragrafi a dhe b të këtij neni, e merr Kryesia e AAK.
3. Kryesia e Partisë merr vendim për përjashtimin e anëtarit:
 - a. Me propozim të Komisionit Etik;
 - b. Me propozim të Degës;
 - c. Me propozim të Nëndegës;
 - d. Me propozim të Kryesisë së AAK.
4. Propozimi për përjashtim bëhet nëse: anëtari është anëtarësuar në subjekt tjetër politik; merr pjesë në listë/garë zgjedhore të subjekteve të tjera politike pa aprovim të Kryesisë së AAK; merr funksion të emëruarit politik në institucione të qeverisura nga partitë tjera pa aprovimin e Kryesisë së AAK; kur me veprimet dhe qëndrimet e veta dëmton imazhin dhe funksionimin e AAK.
5. Kundër vendimit për përjashtim mund t'i bëhet ankesë Komisionit Statutar të AAK, në afat prej 15 ditësh;
6. Komisioni Statutar e jep mendimin e vet për ankesën dhe i'a drejton Këshillit Drejtues brenda 15 ditëve
7. Ankesën mbi vendimin për përjashtim, si instancë e fundit, e shqyrton Këshilli Drejtues i AAK në afat prej 30 ditësh;
8. Vendimin për përjashtimin nga Kryesia e AAK e merr Këshilli Drejtues.

NENI 8

MIRËNJOHJET

1. AAK iu ndan mirënjohje personave për kontribute të veçanta për Partinë;
2. Ndarja e mirënjohjeve propozohet nga Kryesia e AAK, kurse atë e miraton Këshilli Drejtues. Për këtë veprim njoftohet Kuvendi i ardhshëm i Partisë.

PJESA II - STRUKTURA ORGANIZATIVE E PARTISË

NENI 9

NJËSITË THEMELORE TË ORGANIZIMIT

Njësitë themelore të organizimit dhe veprimit territorial të AAK-së janë nëndegët dhe degët.

NENI 10

NËNDEGA

1. Nëndega është njësia themelore e organizimit të AAK, e cila formohet në territorin e nivelit të lagjeve të qyteteve apo të fshatrave. Të gjitha nëndegët e një komune e përbëjnë Degën e komunës;
2. Me vendim të Kryesisë së Degës, nëndegët mund të formojnë aktive;
3. Në rast se veprohet sipas paragrafit 1 të këtij Neni, Kryesia e Degës miraton rregulloren e funksionimit të tyre, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti;
4. Nëndegët udhëhiqen nga Kryesia e nëndegës dhe Kuvendi i nëndegës;
5. Kryesia e AAK, me rregullore të veçantë, e përcakton numrin dhe mënyrën e krijimit të nëndegëve.

NENI 11

DEGA

1. Dega formohet në territorin e një komune dhe përbehet nga më së paku 5 nëndegë;
2. Kryesia e AAK, varësisht prej specifikave politike dhe veçorive tjera, mund të vendos që brenda një komune të ketë më shumë se një degë;
3. Organet udhëheqëse të degës, janë: Kuvendi, Këshilli Drejtues, Kryetari dhe Kryesia e Degës.

NENI 12

DEGËT SPECIFIKE

1. Kryesia e AAK ka të drejtë t'i propozojë Këshillit Drejtues vendime të posaçme për degët në të cilat rrezikohet funksionimi;
2. Këshilli Drejtues merr vendim për krijimin e këshillave inicuese për ristrukturim të plotë të degëve, aty ku ato kanë dështuar të funksionojnë;
3. Në raste të vendimeve të këtilla, këshillat inicues nuk iu nënshtrohen provizioneve statutare që kanë të bëjnë me formën e organizimit;
4. Këshilli inicues, nën mbikëqyrjen e Kryesisë së AAK, duhet të shndërrohet në degë funksionale në afat prej një (1) viti;
5. Për degët ku madhësia e komunës, qoftë numri i banorëve apo territori, e bëjnë të pamundur organizimin e strukturës sipas këtij Statuti, me propozim të Kryesisë së AAK, Këshilli Drejtues mund të marrë vendim për organizim të veçantë.

NENI 13

ORGANIZIMI I AAK JASHTË KOSOVËS

1. AAK shtrihet edhe jashtë Kosovës, në pajtim me këtë Statut dhe në pajtim me ligjet në fuqi në shtetet përkatëse;
2. Çfarëdo organizimi i AAK jashtë Kosovës duhet ta marr miratimin e Kryesisë së AAK.

3. Me kërkesë të shkruar, organizimet e AAK jashtë Kosovës mund të propozojnë mirënjohje për personalite të shquara, të cilin propozim e miraton Kryesia e AAK;
4. Organizimet e AAK jashtë Kosovës, në cilin do nivel, njoftohen me vendimet dhe veprimet e AAK;
5. Për organizimin e AAK jashtë Kosovës, nëse nuk është paraparë ndryshe, vlejnë rregullat e parapara në këtë Statut;
6. Anëtarët e AAK jashtë Kosovës kanë përgjegjësi ta përkrahin AAK në mënyrë organizative, me kuadro si dhe me krijimin e lidhjeve më të mira me shtetet ku ata veprojnë.

NENI 14

KUVENDI –PËRGJEGJËSITË - NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË AAK

1. Kuvendi (në të gjitha nivelet e organizimit të AAK) është bartës i vullnetit të votuesve të AAK;
2. Kuvendi Qendror i AAK përbën organin më të lartë vendimmarrës në AAK;
3. Kuvendi (varësisht nga niveli i organizimit) ka këto përgjegjësi:
 - a) Analizon veprimtarinë e Partisë për periudhën midis dy kuvendeve; nxjerr rekomandime, rezoluta, vendime dhe përcakton orientimet kryesore të Partisë;
 - b) Përcakton mënyrat e funksionimit dhe të zbatimit të politikës së AAK;
 - c) Miraton ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe Programit politik të AAK (Kuvendi i Përgjithshëm i AAK);
 - d) Shqyrton dhe vlerëson punën e organeve qendrore të AAK (Kuvendi i Përgjithshëm i AAK);
 - e) Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e AAK.
 - f) Zgjedh dhe shkarkon Këshillin Drejtues;
 - g) Shqyrton dhe miraton raportin e Kryesisë për aktivitetin e të gjitha organeve të AAK midis dy Kuvendeve;
4. Në rast të shkeljeve programore dhe statutare Kuvendi ka të drejt të kërkojë votëbesimin për Kryetarin e AAK në pajtim me këtë Statut;
5. Formon komisione pune, si: Komisionin Verifikues, Komisionin e Votimit dhe komisione të tjera, sipas nevojës.

NENI 15

KUVENDI - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI

1. Kuvendi i rregullt zgjedhor mbahet një herë në katër vjet, në çdo nivel të organizimit;
2. Kuvendin e rregullt zgjedhor e thërret Kryetari i AAK (ngjashëm edhe për nivelet tjera të organizimit);
 - a) Kuvendi zgjedhor i punës dhe ai i jashtëzakonshëm, mbahet sipas rendit të ditës, të përcaktuar nga Këshilli Drejtues;
 - b) Kuvendin e hapë Kryetari i AAK (ngjashëm për nivelet tjera të organizimit);
 - c) Kuvendin e udhëheqë Kryesia e Punës së Kuvendit;
 - d) Kryesia e Punës zgjedhet në Kuvend dhe ka mandat vetëm sa zgjasin punimet e Kuvendit.
3. Për mbajtjen e mbledhjes dhe rendin e ditës se Kuvendit, delegatët njoftohen së paku 20 ditë më herët;

4. Kuvendin e Nëndegës e përbëjnë të gjithë anëtarët e AAK në territorin e nëndegës, të cilët i zgjedhin delegatët për Kuvendin Zgjedhor të Degës; Kuvendi i Nëndegës në të njëjtën mbledhje zgjedhë edhe përfaqësuesit e ARK për Kuvendin e Degës, sipas kuotave të parapara me Rregulloren të zgjedhjeve dhe në bazë të këtij Statuti.
5. Kuvendin e Degës e përbëjnë delegatët e zgjedhur në nivelin e nëndegëve, Kryesia aktuale e Degës, asambleistët e zgjedhur komunalë, drejtorët e drejtorive komunale, ndërsa ARK zgjedh 10 përfaqësues për Kuvendin e Degës;
6. Delegimi për Kuvendin Qendror të AAK bëhet në bazë të këtyre kritereve:
 - a) Çdo degë delegon nga 2 delegatë në Kuvendin e AAK;
 - b) Dega, në territorin e së cilës ka mbi 100.000 banorë, delegon edhe 1 delegat shtesë (2+1);
 - c) Delegatë të Kuvendit të AAK, drejtpërdrejt, janë: deputetët dhe ministrat nga radhët e AAK-së, anëtarët e Kryesisë aktuale, të cilët nuk delegohen në Kuvend në bazë të ndonjë kriteri tjetër të paraparë në këtë statut;
 - d) ARK delegon 20 delegatë të zgjedhur në Kuvendin e vet;
 - e) Anëtarësia e AAK jashtë Kosovës përfaqësohet me 20 delegatë, zgjedhja e të cilëve përcaktohet konform neneve 12 dhe 13 të këtij Statuti;
 - f) Delegatët e zgjedhur sipas paragrafëve *a*, *b*, *c*, *d* dhe *e* të këtij neni, përbëjnë 1/3 e numrit të përgjithshëm të delegatëve të Kuvendit;
 - g) 1/3 e delegatëve zgjedhen në Kuvendet e Degëve, në proporcion me numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit qendrore apo lokale;
 - h) 1/3 e delegatëve zgjedhen në kuvendet e degëve, në proporcion me numrin e votuesve të regjistruar në komunë;
 - i) Numrin e saktë të delegatëve, për çdo degë, sipas pikave *g* dhe *h* të këtij neni, sipas propozimit të Sekretarit Ekzekutiv, e cakton Kryesia e AAK;
 - j) Mënyra e zgjedhjes dhe kandidimit përcaktohet me Rregulloren e AAK për zgjedhjet e brendshme;
7. Mbledhjet e Kuvendit janë të hapura për mjetet e informimit, përpos në rastet kur Kryesia e punës së Kuvendit vendosë ndryshe;

NENI 16

SEKRETARIA E KUVENDIT - NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË AAK

1. Sekretari Ekzekutiv i AAK udhëheq me punimet e Kuvendit dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurës administrative dhe teknike në Kuvend;
2. Sekretari Ekzekutiv është përgjegjës për arkivimin e dokumentacionit të mbajtur gjatë punës së Kuvendit;
3. Sekretari Ekzekutiv mbikëqyr punën e Sekretarisë së Kuvendit;
4. Kuvendi i zgjedh 4 anëtarët Sekretarisës së Kuvendit të cilët e ndihmojnë Sekretarin Ekzekutiv në ushtrimin e detyrës së tij;
5. Puna e Sekretarisë së Kuvendit përfundon me mbylljen e punimeve të Kuvendit.

NENI 17

KUVENDI I PARAKOHSHËM DHE KUVENDI I PUNËS - NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË AAK

1. Kuvendi i parakohshëm mund të thirret:
 - a) Në rast të shkeljeve të rënda statutare dhe/ose programore nga udhëheqja e AAK;

- b) Në rast të shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme;
 - c) Në rast të krizave politike dhe kushtetuese në vend;
 - d) Në rast se Këshilli Drejtues nuk aprovon Kryesinë e propozuar nga Kryetari i AAK konform Nenit 18.
 - e) Në rast të dorëheqjes ose vdekjes së Kryetarit të AAK;
2. Kuvendin e Parakohshëm mund ta thërrasë Këshilli Drejtues:
- a) Me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të vet;
 - b) Me kërkesën e Kryesisë së AAK;
 - c) Me kërkesën e 1/3 të delegateve të Kuvendit.
3. Në rast të kërkesës sipas paragrafit 2) të këtij Neni (përveç pikës 1. e), Kryetari dhe Këshilli Drejtues e thërret Kuvendin e Parakohshëm brenda 45 ditëve, prej ditës kur është ushtruar kërkesa me shkrim.
4. Këshilli Drejtues mund të thërrasë Kuvendin, konform paragrafit 2 dhe 3 të këtij Neni.

NENI 18

MOS ZGJEDHJA E KRYESISË

1. Kryetari ia propozon Këshillit Drejtues përbërjen e Kryesisë;
2. Nëse zgjedhja e Kryesisë dështon sipas Nenit 20 të këtij Statuti, Kryetari obligohet që Këshillit Drejtues t'i paraqes propozimin e ri me përbërje të re të Kryesisë.
3. Nëse edhe përbërja e re e propozuar nga Kryetari nuk kalon konform Nenit 20 të këtij Statuti, thirret Kuvendi i Parakohshëm.
4. Kuvendi i Parakohshëm e voton mocionin e votëbesimit për Kryetarin e Partisë.
5. Në rast se Kryetari e merr besimin e Partisë, me automatizëm shkarkohet Këshilli Drejtues dhe zgjidhet i ri konform këtij Statuti.
6. Në rast të kundërt shpallen zgjedhjet e përgjithshme në Parti.

NENI 19

KËSHILLI DREJTUES - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI

1. Këshilli Drejtues zgjedhet nga Kuvendi dhe është organi më i lartë në mes të dy kuvendeve zgjedhore;
2. Këshilli Drejtues mbledhet së paku një herë në tre muaj dhe sipas nevojës. Anëtarët e Këshillit Drejtues njoftohen me datën dhe rendin e ditës së mbledhjes së paku 10 ditë përpara. Këshilli Drejtues mund të thirret edhe në mbledhje të jashtëzakonshme;
3. Këshillin Drejtues e thërret dhe udhëheqë Kryetari i AAK (ngjashëm në të gjitha nivelet e organizimit). Mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të thirren edhe nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues (ngjashëm në të gjitha nivelet e organizimit);
4. Këshilli Drejtues (në të gjitha nivelet e organizimit), me propozim të Kryetarit dhe konform dispozitave të këtij statuti, përcakton periudhën kohore për mbajtjen e zgjedhjeve të brendshme në AAK;
5. Këshilli Drejtues i AAK përbëhet nga:
 - a) Kryetari i AAK,
 - b) Nënkryetarët,
 - c) Sekretari i Përgjithshëm,

- d) Sekretari Organizativ,
 - e) Kryetarët e Degëve,
 - f) Deputetët e Kuvendit të Kosovës nga radhët e AAK,
 - g) Ministrat e Qeverisë së Kosovës nga radhët e AAK,
 - h) 70 anëtarë të zgjedhur drejtpërdrejt nga Kuvendi,
 - i) 5 përfaqësues nga ARK.
6. Këshilli Drejtues i Degës përbëhet nga:
- a) Kryetari i Degës,
 - b) Nënkryetarët,
 - c) Sekretari i Përgjithshëm,
 - d) Sekretari Organizativ,
 - e) Asambleistët e zgjedhur, nga radhët e AAK,
 - f) Drejtorët e Departamenteve në Komunë,
 - g) 30 anëtarë të zgjedhur drejtpërdrejt në Kuvendin e Degës,
 - h) 3 përfaqësues nga ARK.

NENI 20

KËSHILLI DREJTUES - PËRGJEGJËSITË

1. Këshilli Drejtues i AAK aprovon propozimin për programin dhe draft-statutin e partisë;
2. Me propozim të Kryetarit të AAK, në të gjitha nivelet e organizimit, Këshilli Drejtues zgjedh dhe shkarkon Kryesinë e AAK dhe anëtarët e Kryesisë.
3. Për zgjedhjen e Kryesisë së AAK nevojiten 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Nëse pas dy raundeve të votimit nuk zgjedhet Kryesia, në raundin e tretë nevojiten 50% +1 e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues;
4. Këshilli Drejtues i Degës zgjedh Kryetarin e Degës me shumicë të votave të të gjithë anëtarëve;
5. Me propozim të Kryetarit të AAK, miraton listën e kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Kosovës;
6. Shqyrton dhe miraton çdo koalicion në çdo nivel të organizimit të AAK, si dhe shqyrton dhe miraton çështjet konkrete programore në rast të ndonjë koalicioni të lidhur me subjekte të tjera politike në të gjitha nivelet e organizimit dhe të cilat janë të miratuara paraprakisht nga Kryesia e AAK;
7. Me propozimin e Kryesisë emron anëtarët e Komisionit Statutar;
8. Në nivel dege, Këshilli Drejtues, me propozim të Kryesisë së Degës, aprovon listën preliminare për këshilltarë komunalë. Lista preliminare i dërgohet Kryesisë së AAK për aprovim përfundimtar;
9. Këshilli Drejtues i Degës përcakton territorin e veprimit të nëndegës;
10. Këshilli Drejtues i Degës i propozon Kryetarit të AAK kandidatë për deputetë në Kuvendin e Kosovës nga komuna përkatëse;

NENI 21

KRYESIA - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI (NË ÇDO NIVEL TË ORGANIZIMIT NË AAK)

1. Kryesia është organ ekzekutiv i zbatimit të politikave, qëndrimeve dhe vendimeve të aprovuara në Kuvend dhe në Këshillin Drejtues të AAK;

2. Kryesia e AAK përbëhet prej:
 - Kryetarit,
 - Nënkryetarit të Parë,
 - Nënkryetarëve,
 - Sekretarittë Përgjithshëm,
 - Sekretarit Organizativ,
 - Anëtarëve të Kryesisë.
3. Kryesia e Nëndegës ka 7-13 anëtarë;
4. Kryesia e Degës ka 17-31 anëtarë;
5. Kryesia e AAK-së ka 27-39 anëtarë;
6. Kryesia është përgjegjëse për zbatimin e Programit dhe të Statutit të AAK;
7. Është përgjegjëse për organizimin e fushatës zgjedhore, organizimin dhe zgjerimin e anëtarësisë dhe grumbullimit të fondeve;
8. Ndarjen e përgjegjësisë dhe funksionimin e Kryesisë e bën Kryetari i AAK, përmes themelimit të departamenteve për çështje të caktuara dhe emërimit të udhëheqësve të këtyre departamenteve;
9. Në çdo nivel të organizimit, kryetari i ARK është anëtar i Kryesisë ex-officio.

NENI 22

KRYESIA - PËRGJEGJËSITË

1. Nxjerr vendime që kanë të bëjnë me aktivitetin partiak në nivelin e saj të organizimit;
2. Me shumicë të thjeshtë votash, miraton listën e kandidatëve për kryetarë të komunave, për këshilltarë në Kuvendin Komunal dhe listën e kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Kosovës, të cilën ia paraqet për aprovim Këshillit Drejtues;
3. Formon komisione dhe grupe pune për detyra konkrete;
4. I formon departamentet dhe i emëron Kryesuesit e tyre;
5. Emëron Sekretarin Ekzekutiv dhe miraton planin e tij të punës;
6. Propozon Rregulloren për Kuvendet Zgjedhore të AAK (në çdo nivel të organizimit), e cila miratohet në Këshillin Drejtues të AAK;
7. Vlerëson rregullësinë e kuvendeve në nivel dege dhe nëndege;
8. Në rast të shkeljeve të Rregullores ose Statutit, i drejtohet Komisionit Statutar për opinion dhe e merr vendimin final për rregullësinë, duke u bazuar në raportin e Komisionit Statutar;
9. Miraton buxhetin e AAK, të propozuar nga Sekretari Ekzekutiv;

NENI 23

KRYETARI – FUNKSIONI DHE PËRGJEGJËSITË (NË ÇDO NIVEL TË ORGANIZIMIT NË AAK)

1. Propozon përbërjen e Kryesisë së AAK, të cilën e aprovon Këshilli Drejtues (në nivel qendror dhe nivel dege);
2. Udhëheq dhe përfaqëson partinë (degën ose nëndegën, varësisht nga niveli i organizimit);
3. Është përgjegjës për zbatimin e Programit dhe të Statutit të AAK dhe përcaktimin e orientimeve politike dhe organizative;
4. Emëron këshilltarët e vet, dhe cakton delegacionin në takimet zyrtare;
5. Pas vendimit të Këshillit Drejtues, thërret Kuvendin e Rregullt të AAK;
6. Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kryesisë dhe Këshillit Drejtues;

7. Propozon dhe nënshkruan marrëveshjet politike për koalicion, memorandumet politike të të gjitha niveleve të organizimit të AAK, të cilat shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i AAK;
8. Përpunën e vet i përgjigjet Kuvendit dhe Këshillit Drejtues të AAK;
9. Në rast të dorëheqjes, pamundësisë fizike apo të vdekjes, deri në Kuvendin e radhës, Kryetarin e zëvendëson Nënkryetari i Parë, e në pamundësi të tij, njëri nga nënkryetarët i përcaktuar nga Këshilli Drejtues brenda periudhës prej 30 ditësh;
10. Në rast të zgjedhjes së tij në postin e Kryetarit të shtetit, dorëhiqet nga posti i Kryetarit të AAK.

NENI 24

NËNKRYETARËT

1. AAK ka Nënkryetarin e Parë dhe nënkryetarët tjerë, të cilët e ndihmojnë Kryetarin e AAK në ushtrimin e detyrës së tij dhe e zëvendësojnë në raste të caktuara, në bazë të vendimit të tij.

NENI 25

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

1. Mbikëqyrë zbatimin e politikave të përcaktuara nga Kryesia e AAK;
2. Koordinon punën e Komisioneve profesionale, të themeluara nga Kryesia e AAK;

NENI 26

SEKRETARI ORGANIZATIV

1. Koordinon punën me kryetarët e degëve;
2. I propozon Kryesisë së AAK ndryshime në strukturën e degëve dhe nëndegëve.

NENI 27

SEKRETARI EKZEKUTIV

1. Është përgjegjës për funksionimin e përditshëm organizativ të AAK në të gjitha nivelet;
2. Është udhëheqës i administratës së AAK;
3. Zbaton vendimet e Kryesisë së AAK;
4. Është anëtar i Kryesisë pa të drejtë vote;
5. Asiston Kryetarin gjatë mbledhjeve të Kryesisë dhe ulet menjëherë në të majtë të Kryetarit;
6. Është udhëheqës i aspekteve të komunikimit të brendshëm me të gjitha nivelet;
7. Është Shef i Shtabit Zgjedhor të AAK;
8. Menaxhon procesin e brendshëm zgjedhor në AAK;
9. Udhëheq punimet e Kuvendit të AAK;
10. Udhëheq me aspektet organizative, financiare dhe të marrëdhënieve me publikun, që organizohen në departamente të posaçme;
11. Është përgjegjës për arkivën dhe përditësimin e bazës së të dhënave për anëtarësinë e AAK;

12. Për ushtrimin e detyrave të tij, bashkëpunon drejtpërdrejt me sekretarët organizativë të Degëve;
13. Për punën e tij, i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë së AAK;
14. Zgjedhet nga Kryesia e AAK, pas konkursit të brendshëm;
15. Sekretari Ekzekutiv nuk mund të kandidojë në zgjedhje lokale, në zgjedhje të përgjithshme dhe as në zgjedhje të brendshme të AAK gjatë ushtrimit të mandatit dhe dy vjet pas skadimit të mandatit, dorëheqjes apo shkarkimit;
16. Kandidati për Sekretar Ekzekutiv duhet të ketë kualifikim të lartë arsimor dhe të jetë anëtar i AAK. Kriteret tjera shtesë, i përcakton Kryesia e AAK-së në konkursin e brendshëm.

NENI 28

DEPARTAMENTET PROFESIONALE

1. Kryesia e AAK, me propozim të Kryetarit të AAK i themelon Departamentet Profesionale.
2. Departamentet Profesionale përbëhen nga njohës të fushave përkatëse dhe e kanë udhëheqësin e Departamentit, i cili emërohet nga Kryesia e AAK me propozim të Kryetarit të AAK, në të gjitha nivelet.
3. Departamentet zhvillojnë programe dhe politika konform Programit dhe Statutit të AAK.
4. Politikat ose programet e zhvilluara bëhen zyrtare pas votimit në Kryesinë e AAK.
5. AAK është pronare e të gjitha programeve dhe politikave të zhvilluara nga Departamentet Profesionale të AAK.

NENI 29

DEPARTAMENTI I GRUAS

1. Në kuadër të AAK-së funksionon Departamenti i Gruas.
2. Departamenti i Gruas angazhohet për fuqizimin e gruas në Aleancë dhe shoqëri; për anëtarësimin sa më të madh të grave në AAK si dhe për avansimin e pozitës së gruas në politikë dhe politikëbërje.
3. Departamenti i Gruas themelohet në nivel qendror dhe nëpër degët e AAK-së.
4. Departamenti ka udhëheqësen në nivel qendror dhe degë.
5. Udhëheqësen e Departamentit të Gruas e zgjedh Këshilli Drejtues pas propozimeve që mund të vijnë nga anëtarësia dhe Kryesia e AAK-së.
6. Departamenti i Gruas e ka Rregulloren e vet të cilën e aprovon Këshilli Drejtues i AAK-së.

NENI 30

ZËDHËNËSI I AAK

1. Zëdhënësin e emëron Kryetari i AAK pas propozimit nga Sekretari Ekzekutiv;
2. Zëdhënësi për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të AAK dhe Sekretarit Ekzekutiv;
3. Zëdhënësi e udhëheq Departamentin për Marrëdhënie me Publikun, në kuadër të zyrës së Sekretarit Ekzekutiv;
4. Zëdhënësi merr pjesë në mbledhje të AAK, pa të drejtë vote.

NENI 31

GRUPI PARLAMENTAR I AAK

1. Grupin Parlamentar të AAK e përbëjnë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës nga radhët e AAK dhe deputetët tjerë, të cilët i bashkohen Grupit Parlamentar të AAK.
2. Grupi Parlamentar ka rregulloren e vet të punës;
3. Deputetët e AAK duhet të veprojnë në përputhje me interesat e AAK si dhe vendimet e Kryesisëdhe Këshillit Drejtues të AAK.

NENI 32

KOMISIONI STATUTAR

1. Komisioni Statutar është organ profesional i AAK:
 - a) Komisioni e ka Kryetarin dhe katër anëtarë;
 - b) Anëtarët e Komisionit Statutar janë juristë me përvojë dhe anëtarë me përvojë të gjatë në AAK, të cilët gjatë mandatit në Komisionin Statutar nuk mund të jenë anëtarë të Kryesisë së AAK dhe të Këshillit Drejtues të AAK;
 - c) Komisioni Statutar emërohet nga Këshilli Drejtues i AAK, pas propozimit nga Kryesia e AAK;
2. Komisioni Statutar është përgjegjës për interpretimin e Statutit të AAK;
3. Komisioni Statutar mbron statutshmërinë dhe kontrollin e ndërsjellë të organeve të AAK, shqyrton ankesa dhe kërkesa të kësaj fushe nga anëtarët dhe organet e AAK;
4. Komisioni Statutar mblidhet sipas nevojës;
5. Vendimet e Komisionit Statutar i vërteton dhe zbaton Kryesia e AAK.

NENI 33

KOMISIONI ETIK

1. Komisioni Etik emërohet nga Këshilli Drejtues i AAK, pas propozimit nga Kryesia e AAK;
2. Përbëhet prej së paku 5 (pesë) anëtarëve, të cilët e zgjedhin udhëheqësin e Komisionit;
3. Anëtarët e Komisionit Etik duhet të jenë personalitete me integritet dhe kredibilitet të lartë dhe anëtarë të devotshëm të AAK;

4. Komisioni Etik harton Kodin Etik të AAK, që miratohet nga Kryesia e AAK, dhe mbikëqyrë zbatueshmërinë e tij;
5. I rekomandon Kryesisë së AAK-së masa dhe veprime në rast të shkeljeve të Kodit Etik nga anëtarët e AAK;
6. I propozon Kryetarit dhe Kryesisë së AAK ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave.
7. E harton dhe ia propozon Kryesisë Deklaratën Etike të Anëtarit të AAK.

NENI 34

ALEANCA E TË RINJVE TË KOSOVËS (ARK)

1. Të rinjtë në AAK mund të jenë të organizuar edhe në ARK;
2. ARK ka strukturën e vet të mëvetësishme organizative. Për organizimin dhe strukturimin e ARK, organet e saj nxjerrin aktet e tyre në pajtim me këtë Statut dhe me Programin e AAK;
3. ARK i zgjedh të gjitha organet udhëheqëse në kuvendet e veta me mandat katër vjeçar, në jo më shumë se dy mandate;
4. Anëtarë të ARK mund të jenë qytetarët e moshës deri në 30 vjeç;
5. ARK e ka Kryetarin, Nënkyetarët, Kryesinë dhe Këshillin Drejtues në të gjitha nivelet.

NENI 35

QENDRA PËR HULUMTIM DHE STRATEGJI

1. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka Qendrën për Hulumtim dhe Strategji e cila është Institut për hulumtime dhe studime politike.
2. Qendra e ruan pavarësinë në hulumtim dhe studim.
3. Qendra financohet nga AAK dhe donatorët.
4. Këshilli Drejtues i AAK e zgjedh bordin me njerëz profesional të fushës dhe aprovon aktet themeltare të Qendrës për Hulumtim dhe Strategji.

NENI 36

KOMISIONI PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE DHE NOMINIM

1. Komisioni për përzgjedhje dhe nominime bën verifikimin e të gjitha kandidaturave për pozita të zgjedhura dhe emërime politike në të gjithë nivelet e pushtetit.
2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë të cilët propozohen nga Kryetari i AAK-së dhe votohen nga Këshilli Drejtues i AAK-së.
3. Komisioni funksionon në bazë të Rregullores së vet të cilën e aprovon Këshilli Drejtues.

NENI 37

VOTIMI

Në të gjitha organet qendrore të AAK, Kuvend, Këshill Drejtues, Kryesi dhe në të gjitha nivelet tjera organizative të AAK, votimi është i ligjshëm, nëse në punën e forumit marrin pjesë shumica e thjeshtë:

1. Votimi është i vlefshëm nëse për një vendim votojnë 50%+1 të pranishmëve, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Statut ose akte të tjera në fuqi;
2. Për çështjet politike dhe programore votimi është i hapur;
3. Për çështjet e kuadrove, për cilëndo listë me më shumë kandidatë se numri i paraparë për t'u zgjedhur në një organ, votimi është i fshehtë;
4. Për zgjedhjen e Kryetarit të AAK, votimi është i fshehtë;
5. Vota e anëtarit të AAK është e garantuar. Anëtarit të AAK në asnjë mënyrë nuk mund t'i imponohet votimi. Ai në asnjë mënyrë nuk mund të detyrohet të votojë kundër vullnetit të tij.
6. Keqpërdorimi apo abuzimi me votën e lirë nga ana e anëtarit të AAK sanksionohet me përjashtim të menjëhershëm nga AAK.

NENI 38

PËRFAQËSIMI I GRUAS NË TË GJITHA ORGANET UDHËHEQËSE TË AAK

1. Në Kryesinë e degëve dhe Kryesinë e AAK-së, gruaja merr pjesë me së paku 1/3 e anëtarëve të përgjithshëm;
2. Kryetari i AAK është përgjegjës për zbatimin e kësaj dispozite Statutare.

NENI 39

MJETET PËR PUNË

1. AAK ka xhirollogarinë e vet;
2. AAK realizon të ardhura nga anëtarësia, kontributet vullnetare, donatorët, shitja e prodhimeve me emblemë të AAK-së dhe forma të tjera ligjore;
3. AAK mund të paguajë, sipas kontratës së punës, anëtarët që kryejnë punë në organet e saj.

NENI 40

AUDITIMI

1. Kryesia e AAK mund të kërkojë auditim të brendshëm në çdo kohë;

2. Për auditim mund të organizojë komision profesional ose të angazhojë kompani të specializuar auditimi.

NENI 41

ZHBËRJA E AAK-së

AAK mund të pushojë së ekzistuari në këto raste:

1. Nëse për këtë vendosin 2/3 e të gjithë delegatëve në mbledhjen e Kuvendit të rregullt apo të jashtëzakonshëm;
2. Në rast të zhbërjes, për pasurinë dhe detyrimet e AAK vendosë Kuvendi i AAK.

NENI 42

INTERPRETIMI I STATUTIT

1. Interpretimin autentik të këtij Statuti e bën Kuvendi apo Komisioni Statutar.
2. Në rast të konfliktit të dispozitave, Kryesia e AAK kërkon mendimin juridik nga hartuesit e Statutit, deri në mbajtjen e Kuvendit të ardhshëm.

NENI 43

HYRJA NË FUQI E STATUTIT TË AAK-së

1. Dispozitat e ndryshuara të Statutit të AAK aplikohen nga dita e aprovimit të tyre. Statuti konfirmohet dhe hyn në fuqi në ditën e miratimit në Kuvendin e AAK:
 - a) Për çështjet e të drejtave të Kuvendit të Degës e të Nëndegës, të cilat nuk janë të saktësuara në këtë Statut, vlejné rregullat për të njëjtat çështje të parapara në Kuvend edhe Kryesi të AAK;
 - b) Propozimin për plotësimin dhe ndryshmin e këtij Statutit e jep Kuvendi, Këshilli Drejtues, apo Komisioni Statutar;
 - c) Në rast të kërkesave të veçanta nga institucionet qendrore të AAK, ndryshimet mund t'i bëjë një grup punues i formuar në nivel të Kryesisë së AAK ose Komisioni Statutar. Ato ndryshime i miraton Këshilli Drejtues dhe irikonfirmon Kuvendi i ardhshëm i AAK.

Miratuar nga Kuvendi i Punës i AAK-së, më 30 Qershor 2019